



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.25

Prishtinë, më 23.9.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N 302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Srdjan Popoviq, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Shpejtim Bulliqi, Shukrije Bytyçi, Teuta Haxhiu dhe Mufera Shinik.

Pjesëmarrës të tjerë: Arsim Bajrami, ministër MASHT, përfaqësues nga ministria, përfaqësues të OSBE-së, të KDI-së dhe mediat.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.9.2015;
3. Raportim i ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.9.2015

Procesverbali i mbledhjes së datës 16.9.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Raportim i ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami

Nait Hasani, tha se në kuadër të planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor dhe me qëllim të sqarimit të çështjeve që anëtarët e Komisionit i kanë ngritur, të cilat kanë të bëjnë me çështjet e arsimit, siç janë: fillimi i vitit shkollor 2015/2016, Vendimi i Ministrisë nr. 231/01B, të datës 4.8.2015, gjendja aktuale në arsimin e lartë publik dhe privat, procesi i nostrifikimit të diplomave dhe çështja e procesit të akreditimit, pastaj problematika rreth peshës së çantave shkollore, si dhe veprimet e ndërmarra nga MASHT-i për ngritjen e cilësisë në arsim. Lidhur me këto çështje Komisioni ka vendosur që ministri i arsimit Arsim Bajrami të raportoi para Komisionit.

Arsim Bajrami, ministër i MASHT, diskutimin e tij e filloi me fillimin e vitit shkollor 2015/2016, të cilin e konsideroi të suksesshëm për faktin se janë realizuar dhjetë objektiva, duke përmendur kurrikulën e re, cilësinë në arsim, tekstet shkollore për shkollat e mesme profesionale, ndërsa tha se kanë mbetur pa realizuar tri sfida, të cilat janë: ndërtimi dhe përfundimi i shkollave, procedimi i ligjeve dhe arsimit profesional.

Sa i përket Vendimit të MASHT-it, ministri tha se asnjë institucion i arsimit privat nuk do të licencohet për mësimdhënës, ndërkaq për shkak të mosdëmtimit të mësimdhënësve, u krijua moduli dyvjeçar, me qëllim të moslargimit të mësimdhënësve nga puna.

Ministri foli edhe për rastin e shpërndarjes së teksteve shkollore në Luginë të Preshevës dhe se problemet me të cilat ballafaqohen, janë të natyrës tjetër.

Salih Morina, foli për gjendjen e arsimit në Komunën e Malishevës, paralelizmat në sistemin arsimor, çështjen e agjencisë, si dhe lidhur me arsimin profesional dhe çështjet buxhetore.

Shukrije Bytyçi, foli lidhur me çështjen e konkursit për mësimdhënës në Komunën e Malishevës, që datojnë nga viti 2014, i cili problem po vazhdon që një kohë dhe kërkoi sqarim lidhur me këtë.

Teuta Haxhiu, kërkoi sqarim lidhur me Vendimin e MASHT. Pra si i tillë, a i barazon të gjithë mësimdhënësit, ndërsa sa i përket kësaj, tha se Kolegji AAB a ka qenë i licencuar edhe për programe të edukimit për mësimdhënës dhe sa vite ka zgjatur licencimi, dhe me themelimin e Agjencisë për Akreditim, a janë akredituar programet për mësimdhënie nga bartësit privatë të arsimit të lartë? Gjithashtu foli edhe rreth problematikës së zgjedhjes së drejtorëve në komuna.

Bekim Haxhiu, ngriti problemin e peshës së çantave të ngarkuara të nxënësve, e cila po rezulton me pasoja për shëndetin e nxënësve me deformimet e shtyllës kurrizore, të cilën e konsideron si shqetësim dhe lidhur me këtë kërkon nga ministri të ndërmeren masat për parandalimin e mëtejshëm.

Shpejtim Bulliqi, kërkoi të ndërmerren masa, në mënyrë që librat shkollorëqë ujepen nxënësve, të ruhen dhe të kthehen në fund të vitit dhe të shfytëzohen nga nxënësit e tjerë, në mënyrë që të ruhet buxheti.

Mufera Shinik, ngriti çështjen e nostrifikimit të diplomave të marra para vitit 1999 në gjuhën turke në fakultetet e Turqisë, si dhe kërkoi që në shkollat në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën e komunitetëve, të emërohen edhe zv. drejtorë nga komunitetet.

Ismail Kurteshi, në diskutimin e tij tha se bazuar nga raportet e dala,sa i përket kurrikulës së re, pra që ajo të zbatohet plotësisht, duhet ende kohë dhe nuk mund të jetë e aritur, por duhet të konsiderohet si sfidë. Sa i përket cilësisë në arsim, tha se nivelin e cilësisë në arsim, më së miri e ilustron kërkesa e ambasadores së Gjermanisë në Kosovë, drejtuar institucioneve të arsimit, ku thotë: “Ofroni arsim cilësor, jo vetëm diploma”.

Lidhur me procesin e akreditimit, tha se këtë vit janë akredituar 47 institucione të arsimit të lartë. Shtroi pyetjen: sa mund të jenë kredibile këto akreditime, kur dihet se aktorët kryesor që e kanë bërë akreditimin, janë të akuzuar për korrupsion?

Më tej, shtroi çështjen e mungesës së anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë dhe Këshillit për Botimin e Teksteve Shkollore, si dhe mungesën e teksteve shkollore për shkollat profesionale. Sai përket çështjes së zëvendësimit të mësimdhënësve në pushim të lehonisë ose atyre të sëmurë, mësimdhënësit tjerë nuk mund të futen në lista të pagave për sa kohë që punojnë, si dhe foli për çështjen e kualifikimit të mësimdhënësve që punojnë me fëmijët me nevoja të veçanta, çështjen e gradimit të mësimdhënësve e cila po bëhet në disa shkolla, çështje këto që duhet të shqyrtohen dhe të zgjidhen nga Ministria.

Nait Hasani,ngiti çështjen e Vendimit nr. 231/01B, të nxjerrë më 4.8.2015, lidhur me të diplomuarit në programet e licencuara për përgatitje të mësimdhënësve të ofruara nga bartësit privatë të arsimit të lartë, të cilët kanë qenë të licencuar nga MASHT-i, para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 04/L-37 për arsimin e lartë në Kosovë, të cilin vendim e cilësoi si shkelje të Ligjit për arsimin e lartë.

Ministri Arsim Bajrami, lidhur me këtë tha se neni 16.5 i Ligjit për arsimin e lartë, përcakton qartë që vetëm institucionet publike të arsimit të lartë mund të ofrojnë programe studimi që çojnë në kualifikimin e një mësimdhënësi për t’u punësuar në një shkollë. Me hyrjen në fuqi të Ligjit për arsimin e lartë në vitin 2011, asnjë institucion privat i arsimit të lartë nuk është akredituar për të ofruar programe të edukimit që çojnë në përgatitjen e kuadrove për arsim parauniversitar.

Vendimi nr. 231/01B i nxjerrë më 4.8.2015, rregullon çështjen e të diplomuarve në programet e licencuara për përgatitje të mësimdhënësve të ofruara nga bartësit privatë të arsimit të lartë,që kanë qenë të licencuar nga MASHT-i, para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 04/L-37 për arsimin e lartë në Kosovë.

Me ligjin e vjetër, MASHT ka bartur edhe procesin e akreditimit përmes licencimit. Në këtë rast, më 14 dhjetor 2007, me vendimin nr. 1587/02-1, bartësi privat i arsimit të lartë, në atë kohë Universiteti AAB, ka qenë i licencuar, ndër tjera edhe për programe të edukimit që të përgatisin

kuadro për mësimdhënës, në kohëzgjatje prej 5 vite (2006/2011). Kjo licencë dhe licencat tjera eventuale përprograme të edukimit që mund t'u jenë dhënë institucioneve private të arsimit të lartë kanë qenë valide dhe nuk kanë pasur asnjë pengesë ligjore.

Qëllimi i Vendimit nr. 231/01B, i nxjerrë më 4.8.2015, ndërlidhet me mundësinë që do t'ju ofrohet të diplomuarve në këto programe për të aplikuar për licencë të mësimdhënies në Kosovë. Këta të diplomuar në këto institucione dhe në programet për mësimdhënie, me këtë vendim, do të konsiderohen të barabartë me të diplomuarit në programet e njëjta të ofruara nga universitetet publike dhe kanë të drejtë të aplikojnë dhe të marrin licencë për mësimdhënie në shkollat e Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 15:35.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani